REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 82/24 Prot.
Datë: 14.01.2020

Nr.________Prot. Vlorë, më 09.01.2020

**VENDIM**

**Nr. 24, datë 9.01.2020**

**PËR**
**MIRATIMIN E RREGULLORES SË DIPLOMIMIT**
**NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË**
**"BACHELOR" NË "DREJTËSI"**

Mbështetur në shkronjën **d** të pikës **1** në nenin **38** në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën **dh** të pikës **1** në nenin **19** në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren e diplomimit në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Drejtësi" (bashkëlidhur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

# RREGULLORE DIPLOMIMI NË PROGRAMIN E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË: "BACHELOR" NË "DREJTËSI"

## Neni 1
*Baza Ligjore*

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

## Neni 2
*Qëllimi dhe objektivat e Rregullores*

Studentët e Departamentit të Drejtësisë në FSHH duhet të realizojnë një temë diplome për të marrë diplomën "Bachelor" në "Drejtësi" duke përpunuar në mënyrë individuale një tematikë në një fushe të caktuar kërkimore shkencore. Rregullorja ka për qëllim të sigurojë:

a) Ndërtimin e një plani të detajuar të një projekti kërkimor;
b) Rishikimin e literaturës relevante për temën e përzgjedhur;
c) Identifikimin e problematikave të punimit shkencor;
d) Përcaktimin e metodologjisë dhe metodave të kërkimit shkencor;
e) Formulimin e pyetjeve të duhura kërkimore dhe hipotezave.

## Neni 3
*Fusha e veprimit të rregullores*

Fusha e veprimit të rregullores lidhet me përgatitjen e temës së diplomës, në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë, në Departamentin e Drejtësisë nga aplikimi deri në përfundim.

## Neni 4
*Përzgjedhja e temës së diplomës*

Temat e paraqitura nga departamenti, do të përzgjidhen në mënyrë të lirë nga çdo student. Pedagogu i Departamentit të Drejtësisë vendos në dispozicion të studentëve listën e temave për udhëheqje;
Çdo student ka të drejtë të zgjedhë pedagogun udhëheqës për temën e tij;
E njëjta temë nuk mund të trajtohet nga dy ose më shumw studentë, me përjashtim të rasteve kur studentët e trajtojnë çështjen në këndvwshtrime të ndryshme;

Departamenti, brenda muajit Tetor të vitit akademik në vazhdim, shpall temat e diplomave, të cilat udhëhiqen nga pedagogë me grada dhe tituj shkencorë.
Në procesin e përzgjedhjes së një teme, studenti duhet të marr parasysh pikat e mëposhtme:

a) Interesin personal për temën e diplomës, që do të sigurojë përfundimin në kohë të temës.
b) Tema duhet të jetë e interpretueshme duke përdorur një trajtim interesant dhe koncepte të përshtatshme.
c) Tema duhet të jetë e pranueshme, pra, duhet të trajtoj probleme në lidhje me temën, duke përdorur të dhënat në dispozicion.
d) Tema është aktuale dhe e rëndësishme.

**Neni 5**
*Udhëheqësi shkencor i temës*

Roli i udhëheqësit shkencor është të këshillojë kandidatët në të gjitha aspektet e projektit kërkimor duke përfshirë:

a) Fushën e temës dhe literaturën relevante.
b) Specifikimin e pyetjeve të hulumtimit.
c) Shkallën kohore të hulumtimit.
d) Strukturën e tezës ose të punimit kërkimor shkencor.

Nëse studenti zgjedh një udhëheqës të jashtëm, tema duhet të pranohet nga një prej grupeve mësimore kërkimore të Departamentit të Drejtësisë në përputhje me fushën e kërkimit.

**Neni 6**
*Roli i oponentit*

Roli i oponentit është:

a) Të shqyrtojë në mënyrë kritike tezën në kuptim të përmbajtjes shkencore, strukturës, qartësisë dhe formës.
b) Të ndihmojë autorin e tezës në përmirësimin e saj (nëse kërkohet).
c) Të sigurojë një mundësi për diskutimin e rezultateve.

Në ditën e prezantimit të tezës, oponenti duhet të:

a) Të paraqesë një prezantim shumë të shkurtër (5 fjali) se për çfarë bën fjalë teza.
b) Të jap vlerësimin e përmbajtjes shkencore të tezës.
c) Të zgjedh një ose më shumë pyetje shkencore për të diskutuar me autorin e tezës.
d) Të kërkojë sqarime, nëse një pjesë e tezës së studentit nuk është e qartë.
e) Të vlerësojë tezën në lidhje me strukturën, qartësinë dhe formësimin.
f) Të ofrojë një vlerësim të shkurtër dhe përmbledhës të tezës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË

Koha e paraqitjes së oponencës nuk duhet të jetë më shumë se 15 minuta.

**Neni 7**
*Modalitetet për dhënien e diplomës në programin Bachelor në Drejtësi*

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës "Bachelor" në "Drejtësi" në Fakultetin e Shkencave Humane të UV janë:

1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat:
   - e formimit të përgjithshëm
   - karakterizuese
   - ndërdisiplinore, të lidhura me disiplinat karakterizuese
2. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në:
   - module të disiplinave me zgjedhje
   - module për njohuri të tjera formuese (gjuhë e huaj, njohuri statistikore, kompjuterike)
3. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në temën e diplomës
4. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 180 ECTS (kredite).

**Neni 8**
*Karakteristikat e Temës së Diplomës*

Të gjithë studentët që përfundojnë më sukses ciklin pesë vjeçar të studimeve në drejtësi diplomohen me temë diplome. Tema e Diplomës realizohet në përputhje me kriteret e temës së diplomës (Shtojca Nr. 1) të miratuara në Departamentitn e Drejtësisë si dhe me aktet nënligjore në fuqi.

**Neni 9**
*Vlerësimi i tezës së diplomës*

a) Parakusht i paraqitjes përfundimtare të temës së diplomës është përfundimi i provimeve në të gjitha lëndët e programit mësimor dhe tema e diplomës është miratuar nga udhëheqësi i temës.
b) Udhëheqësi vlerëson temën e diplomës së dorëzuar. Vlerësimi me shkrim konsideron pajtueshmërinë e materialit me kërkesat formale dhe përmbajtjen e kërkuar, dhe përfshin vlerësimin e punës së studentit. Udhëheqësi e vlerëson temën e diplomës në përputhje me Shtojcën Nr. 6 bashkangjitur kësaj rregulloreje.
c) Drejtuesi i Departamentit cakton një oponent i cili vlerëson me shkrim punimin e studentit.
d) Mbrojtja e tezës së diplomës përfshin një prezantim maksimal prej 15 minuta, duke përmbledhur problematikën, elementet dhe konkluzionet më të rëndësishme të temës së diplomës. Prezantimi bëhet me PowerPoint dhe studenti duhet t'iu përgjigjet

pyetjeve të bëra nga një Komisioni *ad hoc* i ngritur nga Përgjegjësi i Departamentit dhe/ose nga oponenti.

e) Në rastin e një udhëheqësi të jashtëm, ai/ajo duhet të jenë të pranishëm në procesin e mbrojtjes.

f) Kriteret e vlerësimit bëhen në përputhje me Shtojcën Nr. 7 bashkangjitur kësaj Rregulloreje.

**Neni 10**
*Marrja e diplomës*

1. Studenti që ka përmbushur të gjitha detyrimet e programit të studimit dhe ka mbrojtur temën e diplomës, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me listën e notave të fituara gjatë viteve të studimit.

2. Diploma nënshkruhet nga Dekani dhe Rektori i Universitetit të Vlorës. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit.

3. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni publike, në të cilën marrin pjesë autoritete të Universitetit të Vlorës dhe autoritete të tjera të njohura .

4. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës. Nëse prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqjen e diplomës mund ta bëjë çdo person i pajisur me prokurë të posaçme, duke paraqitur dhe letërnjoftimin e tij. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt.

5. Studentit, i cili humbet të drejtën për t'u diplomuar, i lëshohet një vërtetim për vitet e kryera, si dhe lista e notave, ku shënohen të gjitha lëndët me kreditet e fituara dhe nota përkatëse, si dhe nota mesatare e ponderuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
## SENATI AKADEMIK

## SHTOJCA Nr. 1
**(Hartuar sipas Vendimit nr. 76, datë 05.12.2016 të Senatit Akademik të UV-së)**

## STRUKTURA DHE KRITERET E REALIZIMIT TË TEMËS SË DIPLOMËS NË PROGRAMIN E STUDIMEVE "BACHELOR" NË "DREJTËSI"

### TABELA E PËRMBAJTJES


1. Përkufizimi i një teme diplome

2. Kërkesa teknike për punimin shkencor

Formati
Lidhja
Gjatësia e punimit
Lloji i letrës
Shtypja
Cilësia e shtypjes
Margjinat
Numrat e faqeve
Shënimet
Tabelat
Diagramet
Materialet shoqëruese

3. Struktura e punimit shkencor

Abstrakti
Mirënjohje
Tabela e Përmbajtjes
Studimi
Hyrje
Sfondi teorik (gjetjet dhe analizat)
Metodologjia
Pyetje kërkimore dhe Hipoteza
Diskutimi
Përfundime
Bibliografia
Shtojcat

4. Etika e kërkimit


REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

## 1. Përkufizimi i një teme diplome

Një temë diplome është një punë origjinale e prodhuar nga një student në formë të shkruar. Tema e diplomës duhet të tregojë, se studenti është në gjendje të punojë në mënyrë akademike dhe është njohur me teoritë/doktrinën kryesore të botuara në lidhje me temën. Një temë e mirë duhet të jetë e hulumtuar tërësisht, të demonstrojë mendim kritik rigoroz dhe analiza, të paraqes një metodologji të detajuar dhe rezultate të sakta, si dhe të përfshijë verifikimin e kërkesave dhe njohurive.

## 2. Kërkesat teknike për punimin shkencor

### Formati

Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet, deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit. Tema e diplomës duhet të përmbajnë jo më pak se 50 faqe duke përjashtuar referencat bibliografike dhe çdo shtojcë, që siguron mbështetje në informacion.

### Lidhja

Tre kopje të punimit shkencor duhet të lidhen, si libër. Njëra prej kopjeve duhet të jetë origjinalja. Në kopertinë duhet të vendoset emri i universitetit, i departamentit, i ciklit të studimeve, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes. Sfondi i kopertinës së punimit duhet të jetë me ngjyrë blu dhe shkronjat me ngjyrë të verdhë. Shikoni modelin e bashkangjitur në këtë paketë. Pjesa e pasme e kopertinës e cila duhet të jetë po me ngjyrë blu dhe shkronjat me ngjyrë të verdhë duhet të përmbajë:

- Abstraktin në shqip dhe në anglisht. Secili variant duhet të përmbajë 200-300 fjalë. Përdoret madhësia 10-she e shkronjave. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë, se si është trajtuar subjekti në të. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare.
- Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë për identifikimin e tezës në katalogët kolektivë në biblioteka.

Shikoni formatin e pjesës së pasme të kopertinës bashkangjitur në këtë paketë.

### Gjatësia e punimit

Pjesa e studimit shkencor për diplomën

• "Bachelor" në "Drejtësi" duhet të ketë, si rregull jo më pak se 50 faqe të formatit A4.

Referencat, shënimet në fund të faqes, shtojcat, tabelat dhe diagramet nuk përfshihen në këtë përllogaritje.

Vendi që zënë elementet e punimit:

- Hyrja - 10%
- Sfondi teorik (gjetjet dhe analizat) - 10%

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

- Pyetje kërkimore dhe Hipoteza- 15%
- Metodologjia - 15%
- Diskutimi - 30%
- Përfundime dhe propozime - 10%
- Bibliografia - 10%

**Lloji i letrës**
Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.

**Shtypja**
Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Të gjitha kopjet e studimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranohen.

**Cilësia e shtypjes**
Teksti duhet të shtypet me hapësirë një e gjysmë ndërmjet radhëve (1.5). Hapësira njëshe do të përdoret për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë. Duhet përdorur vetëm një lloj shkrimi. Lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman. Masa e shkronjës duhet të jetë 12-she, me justify.

**Margjinat**
Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:
- margjina e sipërme: 1";
- margjina e poshtme: 1";
- margjina e majtë: 1";
- margjina e djathtë: 1".

**Numrat e faqeve**
Të gjithë numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes. Hyrja duhet të ketë numra romakë. Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë. Faqet e bibliografisë dhe shtojcave duhet të numërohen me numra arabë, duke vijuar sipas numrave të tekstit.

**Shënimet**
Në shkencat sociale dhe humane përdoren gjerësisht shënimet. Studentët këshillohen të përdorin referenca të botimeve të ndryshme të fushës, të raporteve ose të disertacioneve të kandidatëve të suksesshëm, të cilat mund të gjenden në biblioteka. Madhësia e shkronjave të shënimeve është më e vogël, se ajo e tekstit. Shënimet në fund të faqes, si dhe të gjitha llojet e tjera të shënimeve, duhet të shkruhen me shkronja me madhësi 10-she.

**Tabelat**
Tabelat është mirë të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

numër arab. Numri i tabelës duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala "tabelë", numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër, legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate, referencat duhet të theksohen.

**Diagramet**
Nëse diagramet paraqiten, si fotografi duhet të vendosen në faqen përkatëse; ilustrimet ose grafikët jo gjithmonë e ndjekin tekstin ose tabelën. Fjala "figurë", numri i diagramit me shifër Web-site: www.univlora.edu.al e-mail: info@univlora.edu.al Faqe 6 nga 9 arabe dhe shpjegimet duhet të vendosen poshtë diagramit. Përgjithësisht, një diagram nuk duhet ta kalojë një faqe. Nëse diagrami vazhdon në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli për tabelat. Si edhe tabelat, diagramet duhet të mblidhen bashkë dhe t'u vihen numra ndjekës. Fotografitë që janë më të vogla, se një faqe duhet të vendosen në faqen përkatëse.

**Materialet shoqëruese**
Nëse një punim përmban materiale shoqëruese, të tilla si: disketa kompjuteri, CD, DVD, kaseta video, etj., që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t'i bashkëngjiten punimit.

## 3. Struktura e punimit shkencor

Punimi shkencor duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore:
Abstrakti
Mirënjohja
Tabela e përmbajtjes
Lista e tabelave, diagrameve
Studimi
Hyrja
Sfondi teorik (gjetjet dhe analizat)
Pyetje kërkimore dhe Hipoteza
Metodologjia
Diskutimi
Përfundime dhe propozime
Bibliografia
Shtojca

Abstrakti ( 200-300 fjalë)
Abstrakti përmbledhë shkurtimisht pyetjen (et) e hulumtimit, metodologjinë dhe gjetjet kyçe. Në fjalinë e fundit duhet të sigurohet përfundimi i hulumtimit. Në abstrakt duhet të paraqiten të paktën pesë fjalë kyçe. Abstrakti për një punim kërkimor shkencor duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Cila është lënda/tema/çështja në fjalë?

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" - VLORË

- Cila është korniza konceptuale/teorike, që udhëheq punimin dhe pyetjen kërkimore shkencore?
- Cilat janë metodologjitë e propozuara dhe teknikat e hulumtimit, që do të përdoren (varen nga teza)?
- Cilat janë gjetjet e parashikuara dhe ndikimet e tyre?

Mirënjohje

Shkrimi i një teme diplome kërkon energji, motivim dhe bindje. Ajo është një përpjekje, që rrallë arrihet vetëm. Kështu, është praktikë e zakonshme njohja e kontributit të personave, që drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë ndihmuar në arritjen e qëllimit. Natyrisht, zgjedhja për të pasur një seksion mirënjohjeje është një vendim personal. Studenti që zgjedh këtë mundësi do ta bëjë këtë në një mënyrë të thjeshtë dhe efikase, në një ose dy paragraf në një faqe të veçantë të pozicionuar vetëm përpara tabelës së përmbajtjes.

Në lidhje me dedikimin, i cili gjithashtu vjen përpara tabelës së përmbajtjes (por pas mirënjohjes), studenti vendos një ose disa njerëz, të cilët kanë luajtur një rol kuptimplotë. Edhe ajo sigurisht është fakultative.

Tabela e Përmbajtjes

Në këtë seksion paraqitet tabela e përmbajtjes me elementet e strukturës së punimit, titujt përkatës dhe numrin e faqeve për secilin element.

Studimi

Studimi, përgjithësisht, duhet të ketë këtë format:

(i) Hyrje

Hyrja përcakton parametrat e gjerë të fushës për t'u adresuar dhe ofron një mënyrë drejtimi të asaj që vijon. Gjithashtu, hyrja duhet të merret me pyetjet, që frymëzuan interesin tuaj kërkimor duke i vendosur ato në kontekstin e saj më të gjerë konceptual dhe kontributi i mundshëm i hulumtimit të propozuar duhet të shpjegohet. Në kapitullin e parë, tregoni qartë se cili është qëllimi i studimit dhe shpjegoni rëndësinë e studimit. Rëndësia trajtohet duke diskutuar, se si studimi shton njohuritë teorike në këtë fushë dhe rëndësinë praktike të studimit për profesionistët në fushën, që shqyrtohet. Veçanërisht e rëndësishme është, që ky kapitull të zhvillohet mirë duke përcaktuar në mënyrë të qartë qëllimet që në fillim.

*Elementet e adresuara në hyrje:*

- Cila është çështja?
- Cila është historia? - Përmbledhje e gjerë dhe koncize.
- Cili është konteksti teorik brenda të cilit mbështetet teza?
- Cilat janë qëllimet dhe objektivat e hulumtimit?
- Struktura e temës

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

(ii) Sfondi teorik (gjetjet dhe analizat)

Stili i prezantimit i adoptuar kryesisht lidhet me faktin, nëse gjetjet janë sasiore ose cilësore në natyrë. Pa marrë parasysh, se si paraqiten të dhënat dhe analizat bazë duhet të ndiqet një diskutim, që shqyrton gjetjet kryesore dhe i vendos këto në kontekstin e pyetjeve të hulumtimit dhe literaturën e përshkruar në hyrje. Duhet të ofrohen sqarime për gjetjet dhe komentet reflektuese në hartimin e hulumtimit dhe metodologjinë e dhënë.

Ky kapitull adreson rezultatet vetëm nga analiza e të dhënave tuaja. Zakonisht filloni me një analizë përshkruese dhe më pas adresoni rezultatet e testeve të hipotezave. Tabelat dhe/ose shifrat duhet të përdoren për të ilustruar dhe përmbledhur të gjithë informacionin numerik. Nëse keni kryer grupe fokusi ose intervista, shpesh është e përshtatshme, që të ofroni së pari profilin e shkurtër përshkrues (p.sh., demografik) të pjesëmarrësve. Në disa raste, kjo analizë përfshin gjithashtu informacione nga shënimet në terren ose të dhëna të tjera interpretuese.

(iii) Metodologjia

Ky kapitull përshkruan metodën e mbledhjes së të dhënave të përdorura dhe mënyrën e përdorur për të analizuar të dhënat tuaja. Mund të filloni duke përshkruar metodën, që keni zgjedhur dhe pse kjo metodë ishte më e përshtatshme. Duke vepruar kështu, ju duhet të citoni literaturën referuese për metodën dhe detajoni çdo hap të procesit të mbledhjes së të dhënave dhe analizës. Duhet te vendosni, se si metodologjia e propozuar kërkimore, jo vetëm që do të prodhojë të dhëna të vlefshme, por gjithashtu të lehtësojë një analizë, që do të ofrojë përgjigje të njëtrajtshme në pyetjet e paraqitura në fillim. Adresoni disa nga pikat e forta dhe dobësitë e qasjes suaj dhe specifikoni, se çfarë tenton të zbulojë metoda juaj. Identifikoni burimet e informacionit ose të dhënat, që do të përdoren për studimin dhe jepni çdo informacion që keni për cilësinë ose disponueshmërinë e këtyre të dhënave.

Metodologjia ka të bëjë me një grup konceptesh dhe kuptimesh rreth dukurive sociale dhe juridike. Metodat janë mjetet, teknikat dhe procedurat me të cilat analizohet materiali empirik dhe arrihen rezultatet e kërkimit shkencor. Metodat e përzgjedhura nga studenti mund të jenë; metoda normative, metoda analizuese, metoda e interpretimit, metoda krahasuese, metoda historike, etj.

(iv) Pyetje kërkimore dhe Hipoteza

Punimi shkencor duhet të parashikojë në hyrje pyetjet kërkimore dhe hipotezën. Pyetjet e kërkimit kanë rëndësi thelbësore për punimin dhe i japin hulumtimit kahjen e shqyrtimeve. Pyetja e hulumtimit ka funksion të dyfishtë: ajo shpreh qëllimin e temës, si dhe përcakton drejtimin në procesin e hulumtimit. Pyetjet kërkimore shërbejnë për të *përshkruar* dhe *shqyrtuar* një (ose disa) dukuri shoqërore dhe në përgjithësi, të *kuptohet* dhe *shpjegohet* se si dhe pse ekziston kjo dukuri.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Hipotezat janë një pohim i testueshëm, një lloj i veçantë pyetjeje hulumtimi që në fakt nuk është pyetje, por një pohim ose shprehje e marrëdhënieve midis dy ose më shumë koncepteve (variabli i varur dhe i pavarur).

| **Shembull** |
|---|
| Hipoteza - krimi dhe kombësia<br>*Personat nga grupi etnik A ka më shumë të ngjarë të kryejnë krime sesa personat nga grupi etnik B.*<br>Kjo hipotezë flet për një marrëdhënie midis kombësisë dhe kryerjes së krimeve. |
| Pyetja kërkimore: *A ka lidhje midis kombësisë dhe kryerjes së krimeve?* |
| Nën-pyetje kërkimore do të ishte: *A ka më shumë gjasa që personat e grupi etnik A të kryejnë krime më shumë se sa personat nga grupi etnik B?* |

(v) Diskutimi

Qëllimi i këtij kapitulli nuk është vetëm të përsërisni atë që keni gjetur, por më tepër të diskutoni se cilat janë gjetjet tuaja në lidhje me njohuritë teorike të dijes mbi temën tuaj. Filloni duke diskutuar gjetjet tuaja në lidhje me kornizën teorike të paraqitur në literaturën e shqyrtuar. Në disa raste, mund të keni nevojë të prezantoni literaturë të re (veçanërisht me hulumtime cilësore). Ky kapitull gjithashtu duhet të adresojë ndikimet praktike të studimit.

(vi) Përfundime

Ky seksion duhet të paraqes një përmbledhje të vështrimeve kryesore dhe ndikimet e temës, mund të përfshijë mendimin e autorit, përmbledhjen e temës në disa faqe, konstatime për pasojat më të gjera të mundshme, qoftë teorike dhe praktike dhe sugjerime për hulumtime të ardhshme.

*Elementet e adresuara në përfundime janë:*

Përmbledhje e gjetjeve.
Përse gjetjet janë të rëndësishme dhe/ose kundërshtojnë rezultatet e pritura?
Diskutimi i ndikimit në "botën reale" të gjetjeve.
Reflektimet mbi ato aspekte të tezës, që mendoni se duhet të adresohen (dmth kufizimet, mundësitë për hulumtime të mëtejshme).

(vii) Bibliografia

Të gjitha punimet shkencore duhet të përdorin literaturën dhe të tregojnë burimin për citatet që përdorin. Seksioni i bibliografisë duhet të vendoset në faqe më vete. Referencat janë të detyrueshme. Tema e diplomës duhet të përfshijë në brendësi të saj referenca në footnote si dhe bibliografinë në fund të punimit shkencor. Punimi që nuk përmban referenca dhe bibliografi nuk pranohet nga udhëheqësi dhe nga Komisioni i Diplomimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

Punimi duhet të përmbajë burime parësore (Konventa, akte normative etj.) dhe burime dytësore (literaturë, artikuj shkencor etj).

Sistemi i përdorimit të referencave është sistemi i Oksfordit, me citime në fund të faqeve (në footnote) dhe bibliografia e ndarë në burimet përkatëse. Më poshtë listohen një sërë shembujsh për mënyrën e citimit.

| | | |
|---|---|---|
| **Libër (me 1 autor)** | | |
| Shembull footnote | M. Porter, Interpreting the Precautionary Principle, Oxford and Portland, Hart Publishing, 2011, fq. 55. | Inicialja e emrit. Mbiemri, Titulli, Vendi i publikimit, Botues, Viti, numri i faqes. |
| Shembull pasues | Porter, Interpreting the Precautionary Principle, fq. 76. | Mbiemri, Titulli i shkurtuar, fq. |
| Bibliografia | Porter, M., Interpreting the Precautionary Principle, Oxford and Portland, Hart Publishing, 2011. | Mbiemri, Inicialja e emrit., Titulli, Vendi i publikimit, Botuesi, Viti. |
| **Libër (me 2 ose 3 autor)** | | |
| Shembull footnote | G. Hawak and W. Wallance, European Union Law, Paris, Palgrave, 2014, fq. 76. | Inicialja e emrit. Mbiemri dhe Inicialja e emrit. Mbiemri, Titulli, Vendi i publikimit, Botues, Viti, numri i faqes. |
| Shembull pasues | Hawak and Wallance, European Union Law, fq. 32. | Mbiemri dhe Mbiemri, Titulli i shkurtuar, numri i faqes. |
| Bibliografia | Hawak, G., and Wallance, W., European Union Law, Paris, Palgrave, 2014. | Mbiemri, Inicialja e emrit., dhe Inicialja e emrit. Mbiemri, Titulli, Vendi i publikimit, Botuesi, Viti. |
| **Artikull në revistë shkencore (me 1 autor)** | | |
| Shembull footnote | J. Smith, "Human Rights Protection in Albania", Academic Journal of Interdisciplinary Studies, vol. 2, nr. 2, 2014, fq. 95. | Inicialja e emrit. Mbiemri, "Titulli i Artikullit", Emri i Revistes, Volumi, numri, viti, faqja. |
| Shembull pasues | Smith, "Human Rights Protection in Albania", fq. 103. | Mbiemri, Titulli i shkurtuar, faqja. |
| Bibliografia | J. Smith, "Human Rights Protection in Albania", Academic Journal of Interdisciplinary Studies, vol. 4, nr. 3, 2015, fq. 94-104. | Mbiemri, Inicialja e emrit., "Titulli i Artikullit", Emri i Revistës, volumi, numri, viti, numri i faqeve. |
| **Artikull në revistë shkencore (me 2 ose 3 autorë)** | | |
| Shembull footnote | P. Addo and N. Besnier, "When Gifts Become Commodities: Pawnshops, Valuables, and Shame in Tonga and the Tongan Diaspora", Journal of the Royal Anthropological Institute, vol. 14, no. 1, 2008, fq. 39. | Inicialja e emrit. Mbiemri dhe Inicialja e emrit. Mbiemri "Titulli i Artikullit", Emri i Revistës, Volumi, numri, viti, faqja. |
| Shembull pasues | Addo and Besnier, "When Gifts Become Commodities", p. 39. | Mbiemri dhe Mbiemri, Titulli i shkurtuar, faqja. |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

| | | |
|---|---|---|
| Bibliografia | Addo, P., and N. Besnier, "When Gifts Become Commodities: Pawnshops, Valuables, and Shame in Tonga and the Tongan Diaspora", Journal of the Royal Anthropological Institute, vol. 14, no. 1, 2008, pp. 39-50. | Mbiemri, Inicialja e emrit., dhe Inicialja e emrit, Mbiemri, "Titulli i Artikullit", Emri i Revistës, volumi, numri, viti, numri i faqeve. |
| **Artikuj gazetë (të printuara)** | | |
| Shembull footnote | A. Anastasi, "Ja pse vendimi i Kushtetueses nuk i kthen në punë të shkarkuarit nga administrata", SOT news, 11 shkurt 2014, fq. 10. | Inicialja e emrit. Mbiemri, "Emri i Artikullit", titulli i gazetës, data dhe viti, faqja. |
| Shembull pasues | Anastasi "Ja pse vendimi i Kushtetueses nuk i kthen në punë të shkarkuarit nga administrata", fq. 11. | Mbiemri, Titulli i shkurtuar, faqja. |
| Bibliografia | Anastasi., A. "Ja pse vendimi i Kushtetueses nuk i kthen në punë të shkarkuarit nga administrata", SOT news, 11 shkurt 2014. | Mbiemri, Inicialja e emrit., "titulli i artikullit", Emri i Gazetës, data dhe viti. |
| **Artikuj gazete (web)** | | |
| Shembull footnote | K. Krisafi, "Çndodh me detin. Ai marrin çamët pronat me heqjen e Ligjit të Luftës", Dita, 1 shkurt 2018, fq. 7, http://www.gazetadita.al/ksenofon-krisafi-e-verteta-per-detin-dhe-camet/, (parë më 3 Mars 2018). | Inicialja e emrit. Mbiemri, "Emri i Artikullit", Titulli i gazetës, data dhe viti, faqja, URL, (data e aksesit) |
| Shembull pasues | Krisafi, "Ç'ndodh me detin. A i marrin çamët pronat me heqjen e Ligjit të Luftës", fq. 8. | Mbiemri, Titulli i shkurtuar, faqja. |
| Bibliografia | Krisafi, K., "Ç'ndodh me detin. A i marrin çamët pronat me heqjen e Ligjit të Luftës", Dita, 1 shkurt 2018, http://www.gazetadita.al/ksenofon-krisafi-e-verteta-per-detin-dhe-camet/, (parë më 3 Mars 2018). | Mbiemri, Inicialja e emrit., "Titulli i artikullit", Emri i Gazetës, data dhe viti, URL, data e aksesimit. |
| **Burime historike** | | |
| Shembull footnote | Lord C. Cathcart, Diary: Transcript, 1709-28. 16 vols. [A25-A40] National Library of Scotland. | Emri dhe Mbiemri, Titulli, (numri i referencës), Vendi i Burimit, faqja. |
| Shembull pasues | Lord Cathcart. Diary, 1709-28. | Mbiemri, titulli i shkurtuar, faqja. |
| Bibliografia | Cathcart, Lord C., Diary: Transcript, 1709-28. 16 vols. [A25-A40] National Library of Scotland. | Mbiemri, Inicialja e Emrit., Titulli. (Numri i referencës), Vendi i Burimit. |
| **Legjislacion** | | |
| Shembull footnote | Trustees Act 1962 (WA) s90<br><br>Ligji Nr. 8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë" | Titulli i legjislacionit (vendi) seksioni.<br><br>Numri i ligjit, data, emërtimi. |
| Shembull pasues | Trustees 1962 s90 | Titull i shkurtuar, seksioni. |
| Bibliografia | Trustees Act 1962 (WA) s90 | Titulli (vendi) seksioni. |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

| | | |
|---|---|---|
| | Ligji Nr. 8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë". | Numri i ligjit, data, emërtimi. |
| **Çështje gjyqësore** | | |
| Shembull footnote | Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me Nr. 1264, datë 06.03.2014, Shoqëria "Therepeli Security" Sh.p.k. kundër Dega e Doganës Durrës. | Gjykata që e ka dhënë vendimin, numri i vendimit, data, Titulli. |
| Bibliografia | Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me Nr. 1264, datë 06.03.2014, Shoqëria "Therepeli Security" Sh.p.k. kundër Dega e Doganës Durrës. | Gjykata që e ka dhënë vendimin, numri i vendimit, data, Titulli. |
| **Raporte (të printuara)** | | |
| Shembull footnote | D. Palmer, R. Walters dhe G. Coventry, Care, Co-operation and Young 'at risk': the Fitzroy Youth Care Project…final evaluation report, Bundoora, Vic., National Centre for SocioLegal Studies, La Trobe University, 1993, fq. 9. | Inicialja e emrit. Mbiemri, Inicialja e emrit. Mbiemri dhe Inicialja e emrit. Mbiemri, 'Titulli i Raportit', vendi i publikimit, botuesi, viti, faqja. |
| Shembull pasues | Palmer et al, Care, Co-operation dhe Young 'at risk', fq. 9. | Mbiemri i autorit të parë dhe të tjerë, Titulli i shkurtuar, faqja. |
| Bibliografia | D. Palmer, R. Walters dhe G. Coventry, Care, Cooperation and Young 'at risk': the Fitzroy Youth Care Project…final evaluation report, Bundoora, Vic., National Centre for Socio-Legal Studies, La Trobe University, 1993. | Inicialja e emrit, Mbiemri, Titulli, vendi i publikimit, Botuesi, viti, faqja. |
| **Raporte (web)** | | |
| Shembull footnote | H. Douglas dhe L. Godden, "The Decriminalisation of Domestic Violence", Socio-legal Research Centre Reports, 2002, http://www.gu.edu.au/centre/slrc/,(parë më 8 shtator 2004). | Inicialja e emrit. Mbiemri dhe Inicialja e emrit. Mbiemri, "Titulli i Raportit", Botuesi (Qendra), viti, (data e aksesimit). |
| Shembull pasues | Douglas dhe Godden, "The Decriminalisation of Domestic Violence". | Mbiemri, "titull i shkurtuar", faqja. |
| Bibliografia | Douglas, H., dhe L. Godden, "The Decriminalisation of Domestic Violence", Sociolegal Research Centre Reports, 2002, http://www.gu.edu.au/centre/slrc/, (parë më 8 shtator 2004). | Mbiemri. Inicialja e emrit., dhe Inicialja e emrit. Mbiemri, "Titulli i Raportit", Botuesi (Qendra), viti, (data e aksesimit). |

(viii) Shtojcat

Çdo shtojcë duhet të përfshijë vetëm materiale mbështetëse, të dhëna, tabela statistikore dhe/ose transkriptet, që konsiderohen, si thelbësore në vlerësimin e tekstit kryesor. Ato përfshihen në "Shtojca", në mënyrë që të mos e shkëpusin lexuesin nga diskutimet origjinale. Në përgjithësi nuk është e nevojshme të sigurohen të dhëna të papërpunuara, nëse ka një analizë përmbledhëse të siguruar gjatë temës. Megjithatë, detajet e

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

procedurave statistikore komplekse dhe rezultatet relevante, pyetësorët dhe transkriptet e intervistave duhet të përfshihen.

Shtojcat mund të ndahen në seksione. Secila shtojcë ka titullin e vet dhe mund të paraqitet edhe veçmas në faqen e Tabelës së Përmbajtjes. Në këtë rubrikë përfshihen materiale të tilla plotësuese, si: instrumente të ndryshme të kërkimit të përdorura në studim, pyetësorë, intervista, harta, dokumente ligjore, historike, seri fotografish etj. Të gjithë kapitujt, çështjet, rubrikat e studimit renditen me rend numerik. Shtojcat nuk llogariten në numrin e faqeve të punimit.

## 4. ETIKA E KËRKIMIT

- Studimi duhet të jetë punë origjinale e kandidatit.
- Një kandidat nuk lejohet të paraqesë, si punim për diplomën Bachelor një punim që e ka paraqitur për një gradë tjetër në këtë universitet ose në një universitet tjetër, por kandidati nuk ndalohet të përfshijë pjesë të punës, nëse ai tregon qartë cila pjesë e punës është përdorur më parë.
- Një kandidat mund të paraqesë një pjesë kontributi, që është botuar më parë individualisht ose në grup. Nëse puna është pjesë e përpjekjeve të një grupi, një shpjegim për pjesën e shkruar nga kandidati duhet të përfshihet në punim.
- Gjatë periudhës së përgatitjes së punimit shkencor, me lejen e udhëheqësit kandidati mund të botojë pjesë të studimit shkencor.
- Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse, nëse përdoren idetë e të tjerëve.
- Përdorimi i ideve ose i punës së të tjerëve duhet të evidentohet individualisht në tekst ose secili punim i përdorur duhet të shënohet në listën e referencave ose në bibliografi.
- Të gjitha citimet nga punimet e të tjerëve duhet të vendosen në thonjëza dhe t'u shënohet burimi.
- Nëse pasazhet e marra nga të tjerët janë më të gjata, se pesë radhë nuk futen në thonjëza, por shënohet referenca për to.
- Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrore.
- Nëse burimi origjinal nuk gjendet dot, por burimi është përmendur në një dokument tjetër, atëherë të dy dokumentet, burimi origjinal dhe burimi dytësor duhet të jepen.
- Udhëheqësit duhet të sqarojnë, që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por përkundrazi për to ka ndëshkime të ndryshme. Pandershmëria akademike, e cila përfshin deklarime false, të dhëna të rreme, prezantimi i punës së grupit si punë individuale dhe plagjiatura i duhen shpjeguar studentit. Megjithatë, rastet e mosrespektimit të rregullave të citimeve për shkak të pakujdesisë ose të mosdijes do të dallohen nga ato ku pandershmëria është e dukshme dhe e qartë.
- Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur instancave më të larta për veprime të mëtejshme.
- Pronësia intelektuale. E drejta e autorit për punimin (si edhe për një material të botuar) mbrohet nga ligji ndërkombëtar i së drejtës së autorit. Shënimi për rezervimin e të

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË REPUBLIKA E SHQIPËRISË

drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë dhe viti i punimit duhet të vendosen në faqen, që vjen pas titullit të punimit.

## Shtojca 2

## PROJEKTPROPOZIM PËR TEMËN

1. ***Të dhëna të përgjithshme***

Emri i studentit: ________________________________

Programi i studimit: ______________________________

Udhëheqësi i propozuar: ___________________________

2. ***Përshkrimi i projekpropozimit***

*Titulli i temës:*
*Abstrakti:*

- 
- *Fjalët kyçe*
- *Hyrja*
- *Sfondi teorik*
- *Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit*
- *Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit*
- *Metodat dhe teknikat e hulumtimit*
- *Rezultatet e hulumtimit*
- *Literatura*

**Shënim zyrtar:**

Vendimi i marrë nga komisioni përgjegjës .................................. (*emri i komisionit*) më ...............................(*datë*):

Studenti......................................... lejohet të kryejë punimin shkencor me temë

...................................................................................................................

Udhëheqësi shkencor do të jetë:

...................................................

___________________________

(*Firma e personit përgjegjës*)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

**Shtojca 3**

**FORMATI I BALLINËS ME ELEMENTET PASUES**

**PROGRAMI I STUDIMIT** ____________________________________

**TITULLI I TEMËS**

______________________________________________________________

______________________________________________________________

Paraqitur në kërkim të diplomës "Bachelor" në "Drejtësi"

______________________________________________________________

Punuar nga studenti __________________________

Udhëhequr nga Prof. Dr./Prof. asoc/Dr ________________________________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

**Shtojca 4**

**DEKLARATË AKADEMIKE**

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij.
Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

- **TITULLI (shqip, anglisht)**

____________________________________________________________
____________________________________________________________
____________________________________________________________

- **ABSTRAKT (bashkelidh abstraktin e punimit ne shqip dhe ne anglisht)**

- **FUSHA E STUDIMIT (shqip, anglisht)**

________________________________________________________

- **FJALËT KYÇE (shqip dhe anglisht)**

____________________________________________________________
____________________________________________________________
____________________________________________________________
________________________________________

- **ADRESA:** ________________________________________________

**EMRI, MBIEMRI I STUDENTIT**
**NËNSHKRIMI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

**Shtojca 5**

Vlorë, më_____________

## LEJE PËR MBROJTJEN E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Bazuar në përmbushjen e kritereve të përcaktuara në Manualin e Punimit të Diplomës jap lejen për mbrojtjen para Komisionit të Vlerësimit të punimit me temë:
………………………………………………………………………………………………
………………………………………………………………………………………………

përgatitur nga ..........................................................................., student/e e Programit .................................................................................................................... .

**UDHËHEQËSI SHKENCOR**

____________________________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" - VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

**Shtojca 6**

**VLERËSIM I SHKURTËR I UDHËHEQËSIT SHKENCOR**

**PËR PUNIMIN E DIPLOMËS BACHELOR NË DREJTËSI ____________________ ME TEMË:**
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
______________

**PËRGATITUR NGA** __________________________________

________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

**Udhëheqësi shkencor:** __________________________________

**VLORË, më** ______________________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

**Shtojca 7**

**FLETË VLERËSIMI**
**PËR PUNIMIN E DIPLOMËS**

**"BACHELOR" NË DREJTËSI"**

**Emri i studentit:** ____________________________________

**Titulli i temës së punimit:** ____________________________________
____________________________________________________________

| Nr. | Kriteret e vlerësimit | Pikët e parashikuara | Pikët e fituara |
|---|---|---|---|
| 1 | Demonstrimi i një vetëdijeje profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur (përcaktimi i qartë i çështjes kërkimore, përputhja e trajtesës me temën, përshkrimi dhe analiza e thellë e rezultateve, paraqitja e përfundimeve dhe rekomandimeve) | 25 | |
| 2 | Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe i instrumenteve të kërkimit (përcaktimi i detyrës shkencore në përputhje me temën, përcaktimi i hipotezave ose i pyetjeve kërkimore, përcaktim i subjekteve, i kampionit, përzgjedhja e metodave dhe e instrumenteve të përshtatshëm) | 15 | |
| 3 | Origjinaliteti i punimit (formulimi origjinal i temës, këndvështrimi origjinal i temës, struktura origjinale, rezultate dhe analiza origjinale) | 20 | |
| 4 | Dobia e punimit (dobia e punimit për zhvillimin e teorisë, për zbatimin në praktikë, për studime të mëtejshme) | 15 | |
| 5 | Cilësia e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit dhe i rregullave të drejtshkrimit) | 10 | |
| 6 | Paraqitja teknike (respektimi i kërkesave teknike të formatit të punimit) | 05 | |
| 7 | Cilësia e prezantimit | 10 | |
| 8 | **Shuma e pikëve** | | |

**Komisioni i vlerësimit:**

1.
2.
3.
4.
5.

**VLORË, më** ______________________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

**Përgjegjësi i Departamentit të Drejtësisë**

Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skelë

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al